

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Mjedisi Biznesor
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	I
Semestri:	I
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Mjedisi Biznesor, shtjellon si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, njohuritë e përgjithshme mbi sistemin e të menduarit mbi biznesin dhe teoritë organizativ. Organizatat dhe teoritë organizative, Ndryshimi dhe zhvillimi organizative, Ndikimi i Inteligjencës Artificiale ne mjedisin e jashtëm te biznesit, Vizioni, misioni dhe filozofia e organizatave, Mjedisi i brendshëm i biznesit, Analiza SWOT, Konteksti demografik, social dhe kulturor i biznesit, Zhvillimi i analizës PEST, Krijimi i filozofisë dhe misionit te kompanisë, Plani i biznesit - struktura e tij dhe metodologjia e hartimit, Formulimi i objektivave dhe identifikimi i alternativave strategjike, Mjedisi i biznesit ndërkombëtar, Cilat janë përfitimet qe kane nga teknologjia e informacionit, Qeverisja e biznesit, Menaxhimi i korporatave dhe etika e biznesit, Rast studimi - Analizimi i mjedisit, “Esta Midiands Nevoa” për te monitoruar ndryshimin, Objektivat e analizës së mjedisit.
Qëllimet e lëndës	Fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike nga fusha e mjedisit të biznesit. Ofrimi i mundësive për njohjen e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, faktorëve ndikues dhe zbatimin e njohurive të fituara, për vlerësimin e faktorëve që ndikojnë te subjektet (bizneset) për ushtrimin e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese si dhe realizimin e objektivave te organizatat qeveritare dhe të atyre jo fitim prerëse.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. tregojë karakteristikat themelore të aktivitetit të biznesit (ECTS 1). 2. identifikojnë karakteristikat e njeriut ndërmarrës dhe karrierës ndërmarrëse – mjedisi i jashtëm i biznesit (ECTS 1).. 3. njohin mënyrat e themelimit dhe organizimit të bizneseve – mjedisi i brendshëm i biznesit (ECTS 1). 4. të jenë të aftë të përpilojnë planin e biznesit dhe të prezantojnë atë (ECTS 1).

	5. te dine për ndikimin e Inteligjencës Artificiale ne mjedisin e jashtëm biznesor – globalizimin (ECTS 1), 6. të kuptojnë instrumentet kryesore të menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përshtatjen e tij rrethinës në të cilën operon – tregu ndërkombëtar (ECTS 1).		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	10	10
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Kursi zgjat 15 javë me 3 orë leksione dhe/ose ushtrime javore individuale dhe grupore. Ushtrimet do të mbahen në formën e punës individuale dhe grupore në të cilën do të diskutohen shembuj konkretë. Pjesëmarrja aktive është jashtëzakonisht e rëndësishme, kështu që studentët inkurajohen që të ndjekin rregullisht leksione dhe ushtrime dhe të kontribuojnë në diskutimet që zhvillohen në leksione. Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe rasteve studimore, zgjidhjes së detyrave numerike dhe interpretimit të tyre. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 60 pikë (%),		

Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit:

1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme:

- Aktiviteti në mësim (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave.
- Angazhimi (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Objektivi	5
Përmbajtja dhe Analiza	5
Përfundime dhe Prezantim	10
Gjithsej:	20

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 30 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 16 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejt të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e

	lëndës.....30 pikë (%), ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....30 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% - Teori, 40% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% me fokus në teori dhe 40% në ushtrime/detyra praktike. • 90 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 60 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 2 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Paul Wetherly, Dorron Otter, 2018, The Business Environment: Themes and Issues in a Globalizing World, Oxford University Press; 2. Vasilika Kume, Menaxhimi Strategjik 2015																												
Literatura shtesë	1. Britton, Chris, Thompson, Ed, Worthington, 2018, The																												

	Business Environment, Pearson 2. Shyqyri Llaci, Menaxhimi 2008 3. W.Orthington dhe Chris Britton - Mjedisi biznesor Univesiteti de Manfort Leicester Perkthim Nagib Skenderi Afrim ALoku 2015 4. Prof. Dr. Ilia Kristo, Biznesi Ndërkombëtar; 5. Organisations and the Business Environment, David Campbell & Tom Craig, second edition The Business Environment, Ian Worthington and Chris Britton, fift editioStephenP.Robbins&David De Cenzo
<i>Informacion shitesë – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:</i>	*Titulli : “Vendimmarrja në Zhvillimin e Turizmit dhe Gastronomisë dhe Eksplorimi i Alternativave: Një Analizë Rasti e Rrjetit të Restoranteve të “Ballkan Petroll” në Ferizaj”; Autorët : Besarta Rexhepi Sahatqija (PhD Cand.), Aziz Rexhepi Botuar në : Pakistan Journal of Life and Social Sciences , Vol. 22, Issue 2, 2024; https://www.scopus.com/inward/record.uri?eid=2-s2.0-85209746915&doi=10.57239%2fPJLSS-2024-22.2.00921&partnerID=40&md5=8bee0185b185bf7f0ca807d2d5b9
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi i Syllabusit dhe njoftimi me lëndën, Hyrje në Mjedisin e Biznesit Hyrje në lëndë, formularë vlerësimi, literaturë, formim grupesh për projekte. Hyrje në strukturën e lëndës dhe metodologjinë e punës. Objektivat e të nxënit: Të kuptuarit e rolit të biznesit në ekonomi dhe shoqëri. Hyrje në konceptet themelore të mjedisit të biznesit. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Organizatrat dhe Teoritë Organizative Format e organizimit të biznesit, ndërmarrja si njësi organizative, struktura, prodhimi. Objektiva e biznesit çfarë është biznesi nocioni biznes Rëndësia bizneseve në ekonomi të tregut konkurrenca në biznese. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e tretë	Mjedisi i Jashtëm i Biznesit Mega dhe mikro mjedisi, analiza e ndikimeve të jashtme, kuptimi i industrive. Analiza e ndikimeve të jashtme, të kuptuarit e industrive. Katër aktivitetet e procesit analizues të mjedisit të jashtëm Rezultati i pritur nr. 2.
Java e katërt	Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në Analizën e Mjedisit të Jashtëm të Biznesit Studentët do të mësojnë se si IA mbledh dhe interpreton të dhënat për vendimmarrje strategjike. Studimi i kësaj pjese ju pajis me njohuritë e

	nevojshme të menaxhimit strategjik, të tilla si: Shpjegon rëndësinë e të kuptuarit dhe analizimit të mjedisit të jashtëm të firmës. Rezultati i pritur nr. 5.
Java e pestë	Mjedisi i Brendshëm i Biznesit, Burimet e prekshme dhe të paprekshme, vlerat e kompanive, kapacitetet. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e gjashtë	SWOT dhe PEST analiza Analiza SWOT, Zhvillimi i analizës PEST, Vizioni, misioni, filozofia organizative, Konteksti demografik, shoqëror dhe kulturor. Mjedisi i brendshëm i biznesit, Rezultati i pritur nr. 3.
Java e shtatë	Mjedisi biznesor - Konteksti demografik, shoqëror dhe kulturor Parashihet të organizohet Testi i parë, Vlerësimi i njohurive nga java 1-6 deri në testin e parë. Rezultati i pritur nr. 6.
Java e tetë	Plani i Biznesit – Hyrje Çfarë është një plan biznesi, struktura e tij, hapat për hartimin e tij. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e nëntë	Zbatimi i Inteligjencës Artificiale në Zhvillimin e Planit të Biznesit Studentët do të aplikojnë mjete të inteligjencës artificiale për të ndërtuar pjesë të një plani biznesi (analizë, strukturë, parashikime). Metodologjia e Zhvillimit të Planit. Kush e përgatit planin, analizën e tregut, identifikimin e konkurrencës. Rezultati i pritur nr. 5.
Java e dhjetë	Objektivat dhe Strategjitë Objektivat afatgjata, llojet e strategjive, zgjedhja e alternativave strategjike. Rezultati i pritur nr. 2 dh 3.
Java e njëmbëdhjetë	Globalizimi dhe Mjedisi i Biznesit Çfarë është globalizimi, ndikimet në tregjet lokale dhe globale, Rezultati i pritur nr. 6.
Java e dymbëdhjetë	Strategjitë për Hyrjen në Tregjet Ndërkombëtar Metodat e hyrjes në tregjet e huaja (eksporti, partneritetet, investimet direkte). Rëndësia e analizës së mjedisit biznesor në nivel ndërkombëtar. Përshtatja ndaj rregulloreve lokale, kulturës dhe preferencave të konsumatorëve. Rezultati i pritur nr. 6,
Java e trembëdhjetë	Hyrja në Tregjet Ndërkombëtare Eksporti, partneritetet, investimet e huaja, përshtatja me rregulloret lokale. Rezultati i pritur nr. 6.
Java e katërbëdhjetë	Faktorët Politikë dhe Ligjorë Stabiliteti politik, rreziqet gjeopolitike, rregulloret ndërkombëtare. Rezultati i pritur nr. 3,

Java e pesëmbëdhjetë	Tema nga punimi shkencor: Vendimmarrja në zhvillimin e turizmit dhe gastronomisë dhe zgjidhja alternative (Analiza e rastit të rrjetit të restoranteve “Ballkan Petrol” Ferizaj) Rezultati i pritur nr. 3, Parashihet të organizohet Testi i dytë,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	